



CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të BMP përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre

KRYETAR – Z. DRITAN FINO

Edukimi dhe eksperiencia e Z. Fino ka qenë e përqendruar në fushën e kontabilitetit, financës dhe auditimit. Z. Fino zotëron gradën “Doktor i Shkencave”, të realizuar në Universitetin e Kyushu Sangyo, Japoni. Që prej vitit 2007 ka dhënë leksione në institucione të ndryshme në Japoni, Slloveni, Zvicër dhe në Shqipëri, duke përfshirë institucione të arsimit publik dhe atij privat. Z. 14 Fino, përgjatë karrierës së tij, ka dhënë kontribut të rëndësishëm në profesionin kontabël, veçanërisht atë të auditimit, ku vlen të theksohet se më herët përgjatë karrierës së tij është angazhuar si anëtar në Komitetin e Regjistrimit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për regjistrimin e Audituesve Ligjorë, si dhe Kryetar i Komisionit të Kualifikimit dhe Certifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik. Aktualisht, Z. Fino punon si Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ai është bërë pjesë e kësaj Ministrie në muajin nëntor të vitit 2013, si këshilltar pranë Kabinetit të Ministrit, duke mbuluar fusha që lidhen me auditimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar, etj. Z. Fino është anëtar i një sërë grupesh pune që lidhen me çështje të parandalimit të pastrimit të parave, integritit, etj. Ai është autor i një sërë librash dhe artikujsh të ndryshëm të publikuar brenda dhe jashtë vendit.

ANËTARE – ZNJ. ADRIANA BERBERI

Znj. Adriana Berberi ka mbaruar Fakultetin e Ekonomisë, degën e kontabilitetit në vitin 1981. Ka kryer disa kualifikime e trajnime ndërkombëtare. Ajo ka kryer edhe studimet Master shkencor në Studimet Evropiane pranë Universitetit të Tiranës. Znj. Berberi ka një eksperiencë shumë të gjatë në fushën akademike që prej vitit 1983. Gjithashtu, Znj. Berberi është e certifikuar me titullin profesional të Kontabilistit të Miratuar dhe Audituesit Ligjor. Që prej vitit 1997, Znj. Berberi ka mbuluar funksione të rëndësishme si: Zëvendësministër i Financave, Drejtor Kabineti në Kryeministri, Drejtor Kabineti i Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtor Kabineti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Kryetare e Bordit të Mbiqëqyrjes Publike për mandatin e dytë të funksionimit të BMP, etj. Gjithashtu, Znj. Berberi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm përgjatë karrierës së saj në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

ngritjen e kapaciteteve të profesionit kontabël, ku vlen të theksohet se ka qenë anëtare e Këshillit Drejtues të Institutit të Ekspertëve Kontabël, si dhe e angazhuar në proceset e edukimit të kandidatëve të rinj. Znj. Berberi është e emëruar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë si anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

ANËTAR – Z. LUAN ABAZI

Z. Abazi është diplomuar në degën e financës, Fakulteti i Ekonomisë, në vitin 1984. Z. Abazi ka një eksperiencë të gjatë në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit, veçanërisht në institucione të sektorit publik. Gjithashtu, Z. Abazi 15 është certifikuar me titullin profesional të Audituesit Ligjor. Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në forcimin e profesionit kontabël ku edhe me herët përgjatë karrierës, edhe si anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike në mandatin e mëhershëm, ka ndikuar në përmirësimin e një sërë aktivitetesh që prekin profesionin. Aktualisht, ushtron detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Z. Abazi ka një eksperiencë të gjatë në Prokurorinë e Përgjithshme si Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjithashtu, Z. Abazi është i kualifikuar edhe në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, për të cilën është certifikuar në Universitetin Politeknik të Tiranës.

ANËTAR – Z. GJERGJI DURO

Z. Gjergji Duro është diplomuar në vitin 1995 në degën Administrim-Biznesi, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ku ka kryer gjithashtu edhe studimet në nivel master. Z. Duro aktualisht punon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe ka një eksperiencë të gjatë në fushën e tatimeve dhe taksave, fushë e lidhur ngushtë me profesionin kontabël, veçanërisht në institucione të sektorit publik. Përgjatë karrierës së tij, Z. Duro ka mbuluar funksione të rëndësishme si 16 Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në Vend sipas Industrive DTM, Përgjegjës i Sektorit të Analizës së Riskut në Drejtorinë e Kontrollit DPT, Përgjegjës i Sektorit të Operacioneve të Kontrollit, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut në DPT, Anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore, Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor DRT Tiranë, etj., si dhe ka ndjekur një sërë trajnimesh të organizuara nga institucione si OECD, USAID, ITAP, FMN, etj.



ANËTAR – Z. MARTIN MICI

Z. Mici ka kryer studimet e larta në Tiranë ku është diplomuar në degën e Agrobiznesit, si dhe zotëron titullin e Kontabilistit të Miratuar. Fillimisht, Z. Mici e ka ndërtuar karrierën në sektorin privat, ku ka punuar rreth 15 vite në Sektorin Bankar, duke mbajtur pozicione të ndryshme drejtuese, kryesisht me fokus financimin e Biznesit të vogël dhe të mesëm. Më pas ka vijuar punën në Administratën Shtetërore në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Hetimit Tatimor, duke kontribuar në fushën e tatim taksave dhe luftës kundër evazionit, pozicion në të cilin ka marrë kualifikime të ndryshme në luftën kundër skemave të mashtrimit me TVSH. Gjithashtu, Z. Mici ka punuar edhe në Kabinetin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në pozicionin e Këshilltarit të Ministrit. Aktualisht, ai mban detyrën e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive.

Përshkrim të procedurës së zgjedhjes

Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë, si më poshtë:

- a) kryetari dhe tre anëtarë propozohen nga Ministri i Financave, njëri prej të cilëve përzgjidhet nga institucionet e arsimit të lartë;
- b) një anëtar propozohet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Anëtarët e bordit përzgjidhen sipas një procedure transparente dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të kenë shtetësi shqiptare;
- b) të kenë integritet moral dhe profesional;
- c) të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
- ç) të zotërojnë, të paktën, diplomë “Master i shkencave” apo të barasvlershëm me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 10 vite përvojë, ose një gradë apo titull shkencor dhe 7 vite përvojë pune në çështjet e auditimit ligjor dhe të kontabilitetit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

d) të mos kenë lidhje të afërta, deri në shkallë të dytë, me personat në organet e zgjedhura të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

II. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES TË ANËTARËVE TË BORDIT

1. Bordi është organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë jopraktikues, të emëruar nga Ministri i Financave, për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, jo më shumë se dy herë.

2. Kryetari dhe tre anëtarët e Bordit, që propozohen nga Ministri i Financave, duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 4, pika 4 të ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar (këtu e në vijim).

3. Kandidati që përzgjidhet nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, përveç kriterëve të parashikuara në nenin 4, pika 4 të ligjit duhet të jetë pjesë e stafit të përhershëm të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë.

4. Anëtari i pestë i Bordit, i propozuar nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 4, pika 4 të ligjit.

5. Njoftimi për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit, mënyra e vlerësimit të kandidatëve bazuar në kriteret e parashikuara në nenin 4, pika 4 të ligjit, vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit, caktohen me urdhër të Ministrit të Financave.

6. Njoftimi i konkurrimit për anëtar të Bordit përmban këto të dhëna: a) Një përshkrim të shkurtër të kompetencave dhe funksionit që do të mbulojë anëtari; b) Kërkesat për pranimin e kandidatëve; c) Listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet; ç) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen. Njoftimi publikohet, në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në buletin e njoftimeve zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në buletin e Agjensisë së Prokurimit Publik.

7. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit, sipas pikës 2 të këtij kreu, kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur me urdhër të ministrit të Financave, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të hartojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore.

8. Kandidatët që aplikojnë për anëtarë të Bordit, dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentacionin e mëposhtëm:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- a) Kërkesën me shkrim;
 - b) Kopje të pasaportës ose kartës së identitetit (ID);
 - c) Curriculum vitae;
 - ç) Dy vlerësimet e fundit vjetore, në rast se kandidati vjen nga institucionet publike;
 - d) Kopje të noterizuar të librezës së punës;
 - dh) Kopje të noterizuar të diplomës;
 - e) Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit sipas përcaktimeve të pikës 4/d të këtij Kreu.
 - ë) Kopje të noterizuara të dëshmive dhe certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;
 - f) Dëshminë e penalitetit. Dokumentat e përcaktuara në gërmën “ë”, të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.
9. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga shpallja e njoftimit.
10. Komisioni ad-hoc, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga mbyllja e afatit të dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pikës 4, të nenit 4 të ligjit, të shoqëruar me një relacion përmbledhës, e cila i paraqitet për miratim Ministrit të Financave. Në relacion, Komisioni i rekomandon ministrit të Financave emërimin e kandidaturave.
11. Në rastin e anëtarit të Bordit që përzgjidhet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, Ministria e Financave paraqet pranë Kuvendit të Shqipërisë kërkesën për paraqitjen e kandidaturës përkatëse.

Kompetencat dhe detyrat e tyre

Për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë, krijohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur. Bordi ka këto të drejta dhe detyra:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- a) harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në këtë ligj;
- b) mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
- c) miraton formatin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
- ç) miraton kodin e etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
- d) mbikëqyr kontrollin e cilësisë, që realizohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- dh) mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë
- e) miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
- ë) kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;
- f) shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
- g) miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij;
- gj) shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
- h) shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektivit të veprimtarisë së tij.
2. Bordi miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.